

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q.G nga K, për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtur e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2588/17 të datës 16.10.2017, jashtë seancës, me datë 10.04.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2588/17 të datës 16.10.2017, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

**I akuzuari;**

**Q.G**, i ati Sh. i lindur më dt:..., në fshatin Gremnik Komuna e K, ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, – shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse,**

Me datë të pa përcaktuar gjatë muajit Gusht të vitit 2017, në Prishtinë, i pandehuri Q.G nga personi i pa njohur në shumë prej 20 euro ka blerë telefonin e tipit “Leago”, me numër të IMEI-it 355073072306234, pronë e të dëmtuarës A.B, edhe pse ka mundur ta dijë se i njëjti është përfutur me kryerjen e veprës penale të vjedhjes.

**-me këtë ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

### DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**E dëmtuara** – A.B me përfaqësuesin e saj ligjor J.B nga fshati S.M Komuna e F.K, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 2588/17 të datës 16.10.2017, kundër Q.G nga K, për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Informacioni nga operatorët telefonik “V” i datës 10.03.2017, dhe “I” 604-2 i datës 16.08.2017, vërtetimi mbi konfiskimin e sendit i datës 06.04.2017, si dhe shkresa të tjera të cilat gjenden në lëndë, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
 Departamenti i përgjithshëm-Penal  
 P.nr. 4969/17 dt. 10.04.2018

**Zyrtare Ligjore**  
 Dafian Ymeri

**Gjyqtari,**  
 Kujtim Krasniqi

### **KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.